

Përzgjedhja e 60 hetuesve të BKH-së nën mbikqyrjen e FBI

Një ditë pas publikimit të kriterëve të vendosura për përzgjedhjen e 60 hetuesve të Byrosë Kombëtare të Hetimit, ose siç njihet ndryshe FBI-ja shqiptare, këtë të mërkurë drejtuesja e saj, ka bërë të ditur, se procesi do të jetë transparent, i barabartë dhe i drejtë nën mbikqyrjen e Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Në një mesazh të posaçëm, bëhet e ditur, se ekipi i ri do të punojë ngushtësisht dhe nën drejtimin e Prokurorëve të Posaçëm për të hetuar veprat penale në fushën e korrupsionit dhe krimin të organizuar, dhe do garantoj një strukturë të pavarur nga çdo ndikim i paligjshëm, i brendshëm apo i jashtëm.

Procesi i përzgjedhjes përfshin aplikimin elektronik, provimin me shkrim të arsytimit logjik, testin fizik, provimin me shkrim që mat aftësitë e shkrimit të raporteve dhe nivelin e shkrimit e leximit, intervistën që mat aftësitë e komunikimit verbal, aftësitë për ti komunikuar idetë me efikasitet dhe verifikimin e thelluar të pasurisë dhe figurës.

Kandidatët që do të indentifikohen si më të mirët, duke ndjekur të njëjtin proces përzgjedhje si ai që zhvillohet sot për rekrutimet në FBI-së, do të verifikohen për plotësimin e kriterëve të integritetit dhe do ti nënshtrohen testimit të Poligrafit.

Procesi do të asistohet dhe monitorohet nga afër nga Komisioni Ndërkombëtar i Ekspertëve çka garanton transparencë dhe objektivitet maksimal në këtë proces rekrutimi.

Kandidatët fitues, thotë BKH, do t'i nënshtrohen një programi të gjatë trajnimi që do të sigurohet nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara, me trajnerë të specializuar nga Byroja Federale e Hetimit (FBI).

Hapja e garës erdhi pak orë pas takimit të ambasadorja e SHBA-së, Yuri Kim zhvilloi me drejtuesin e SPAK Arben Krajën dhe drejtuesin e BKH-së, Aida Hajnaj.